



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 01/1473 Dt. 09 / 07 / 2021

Në mbështetje të nenit 48 paragrafi 1, nën paragrafi 1.9 dhe 1.10, nenit 233 paragrafi 1 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e XXIV të mbajtur më 30.06.2021, miratoi këtë:

RREGULLORE

MBI PROCEDURAT E ANGAZHIMIT TË BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM-ME HONORARNË UNIVERSITETIN PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo Rregullore është hartuar duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, Ligjit mbi Arsimin e Lartë nr. 04/L-037, UA të MPMS nr. 07/2017 dhe Statutin e Universitetit "Kadri Zeka".

Neni 2

Kjo Rregullore ka për qëllim të rregullojë procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm-me honorar për mbajtjen e ligjëratave, ushtrimeve, kolokuiumeve, konsultimeve si dhe mentorimeve, sipas nevojës së njësisë akademike.

Neni 3

Periudha e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet për një semestër, përkatësisht dy semestra brenda të njëjtit vit akademik.

3.1 Kontratat për angazhim për *semestrin dimëror* lidhen prej datës 1 tetor deri më 15 shkurt për vitin përkatës akademik (për një semestër); për *semestrin veror* kontrata lidhet prej

datës 15 shkurt deri më 30 qershor për vitin përkatës akademik (për një semestër); dhe kontrata për angazhim për *një vit akademik* bëhet për periudhën prej 1 tetor deri më 30 qershor të vitit përkatës akademik (për një vit akademik).

- 3.2 Kompensimi i stafit të angazhuar bëhet bazuar në orët e mbajtura dhe provimet, të dëshmuara me evidencën e nënshkrimeve të studenteve dhe të stafit akademik.
- 3.3 I/e angazhuari/ja ka për obligim që në kuadër të kontratës t'i kryej të gjitha obligimet që dalin nga neni 2 i kësaj rregulloreje.
- 3.4 I/e angazhuari/ja ka për obligim që të mbajë provimet për të gjitha afatet e provimeve deri me fillimin e semestrit të radhës në të cilën ligjërohet lënda përkatëse.

Neni 4

Procedurat e angazhimit bëhen në mënyrë transparente nëpërmjet shpalljes së konkursit publik.

Neni 5

Përjashtim nga neni 4 bëhet nëse për arsye të ndryshme që mund të ndodhin pasi të ketë filluar semestri, mbetet vakante ndonjë pozitë (lëndë) që nuk mund të mbulohet me stafin e rregullte dhe/ose stafin e angazhuar sipas konkursit, atëherë me një arsyetim të bazuar të Dekanit, Rektori vendos që të bëjë angazhim të stafit të jashtëm, i cili i përmbushë kriteret e domosdoshme sipas kësaj rregullore.

PROCEDURAT E SHPALLJES SË KONKURSIT

Neni 6

Shpallja e konkursit bëhet pas miratimit të propozimeve të këshillave të njësive akademike nga Senati.

Rektori, me një arsyetim të bazuar në konsultim me dekanin, mund t'i propozojë Senatit shpalljen e konkursit për angazhim të personelit akademik, pa vendimin e Këshillit të njësive akademike.

Neni 7

Konkursi duhet t'i referohet dispozitave të Ligjit mbi Arsimin e Lartë, Ligjit të Punës dhe kësaj rregulloreje:

- Konkursi shpallet në ueb faqen zyrtare të Universitetit;
- Kohëzgjatja e konkursit është 15 ditë kalendarike, nga dita e shpalljes;
- Kandidatët, të cilët aplikojnë, duhet t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet e kërkuara në konkurs, në kopje fizike, të noterizuara dhe në formë elektronike;
- Diplomat dhe gradat shkencore, të fituara jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-I, para datës së mbylljes së konkursit;

- Dokumentacioni i dorëzuar në konkurs nuk kthehet.

KOMISIONET RECENSUESE

Neni 8

Brenda 7 (shtatë) ditëve, pas hapjes së konkursit, dekani i fakultetit thërret mbledhjen e Këshillit të Fakultetit, në të cilën merret vendim për formimin e komisioneve recensuese.

Neni 9

Komisioni Recensues përbëhet nga 3 (tre) anëtarë nga radha e profesorëve me thirrje akademike nga universitet dhe të ketë kredibilitet profesional dhe akademik.

Anëtarët e komisionit Recensues kompensohen sipas rregullores për të ardhurat personale dhe pagesat tjera të stafit akademik të UKZ-së.

Neni 10

Komisioni Recensues, pas përmbylljes së afatit të konkursit ka për detyrë të thërras mbledhjen e komisionit dhe në koordinim me ta në afat jo më shumë se 10 ditësh të hartojë raportin e vlerësimit, duke pasur parasysh këto obligime:

- 10.1 Të dorëzojë Raportin e Komisionit në Fakultetin përkatës i cili publikohet në webfaqen e UKZ-së jo më larg se 3 ditë nga dorëzimi.
- 10.2 Komisioni ka për obligim të shqyrtojë të gjitha aplikacionet e paraqitura për lëndët përkatëse. Komisioni harton raport për kandidatët që i plotësojnë kushtet formale juridike sipas konkursit.
- 10.3 Për kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet formale juridike, Komisioni duhet të shënojë në raport se cilat prej kushteve nuk i ka plotësuar secili prej kandidatëve.
- 10.4 Raporti i Komisionit duhet të jetë i detajuar për kandidatët e përzgjedhur, ndërsa për secilin kandidat që nuk përzgjidhet duhet të theksohet një a më shumë arsye të mos - përzgjedhjes.
- 10.4 Komisioni Recensues i fton kandidatët që i plotësojnë kushtet formale juridike në intervistë për vlerësim. Komisioni Recensues bazohet edhe në performancë të treguar në UKZ (vlerësimi i ZZHAC për kandidatët e angazhuar në vitet paraprake).
- 10.5 Komisioni mban përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe morale për vlerësimin e të dhënave në raportin e vlerësimit.
- 10.6 Komisioni mban procesverbal, lidhur me trajtimin e kërkesave për angazhim për të gjithë kandidatët e paraqitur në konkurs.

KUSHTET E ANGAZHIMIT

Neni 11

Personeli i angazhuar, në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm, nuk mund të marrë thirrje akademike.

Neni 12

Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm - me honorar, kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

12.1. Për mësimdhënës:

12.1.1. Të kenë gradën shkencore Dr. nga lëmi përkatës (në lëndët e arteve figurative dhe të muzikës grada ekuivalente me të);

12.1.2. Të kenë përvojë pune si mësimdhënës;

12.1.3. Në mungesë të kandidatëve me gradën e doktorit të shkencave (Dr. Sc.) dhe nëse brenda njësisë akademike nuk mund të sigurohet kandidati me gradën e magjistratit (Mr. Sc.) ose Master (MA), i cili do të mund të angazhohej për mbajtjen e ligjëratave në lëndën e caktuar, në përputhje me Statutin, për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjëratë në nivelin Bachelor mund të angazhohet kandidati me gradën Mr. Sc. ose MA, duke i dhënë përparësi kandidatit që ka të regjistruara studimet e doktoratës. Për të njëjtin Këshilli i Fakultetit nxjerr vendim për t'ia besuar lëndën nën përkujdesjen e një profesori në marrëdhënie të rregullt pune në fushën përkatëse.

12.2. Për bashkëpunëtorë për mbajtjen e ushtrimeve:

- Të kenë përfunduar studimet e rregullta Bachelor dhe Master apo ekuivalent në lëmin përkatës;
- Të kenë notën mesatare jo më pak se 8 në të dy nivelet e studimit (veç e veç);
- Studimet themelore dhe ato Master të kenë minimum 300 ECTS
- Kandidatët me gradën më të ultë se Master nuk mund të angazhohen për mbajtjen e ushtrimeve.

12.3. Në UKZ nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët kanë më shumë se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune apo me honorar në institucionet tjera publike apo private me pagë primare apo sekondare

12.4. Në UKZ nuk do të lejohet angazhimi i kandidatëve, brenda një njësie akademike, nëse brenda saj kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjar të ngushtë (në relacion prind-fëmijë, vëlla-motër dhe anasjelltas, si dhe vëlla-vëlla apo motër-motër, bashkëshort- bashkëshorte dhe anasjelltas).

E DREJTA E ANKESËS

Neni 13

Kandidatët e pakënaqur me Vlerësimin e Komisionit vlerësues kanë të drejtë ankese, në afatin prej 3 ditësh nga dita e publikimit në webfaqe të UKZ, drejtuar Këshillit të Fakultetit.

Neni 14

Komisioni i ankesave, i cili formohet nga Këshilli i Fakultetit dhe i cili përbëhet nga 3 anëtarë, pas përfundimit të afatit të ankesave do të përpilojë raportin dhe propozimet përkatëse dhe të njëjtin t'ia dorëzojë Këshillit të Fakultetit. Raporti duhet të përgatitet brenda 3 ditëve.

Neni 15

Këshilli i Fakultetit, jo më shumë se 3 ditë nga afati i ankesave duhet të shqyrtojë propozimet e Komisionit të ankesave dhe të vendosë për miratimin apo refuzimin e tyre.

Neni 16

1. Senati e mban mbledhjen brenda 7 ditëve pas miratimit të raporteve përfundimtare dhe të ankesave nga këshillat e fakulteteve.
2. Senati, me shumicë votash, voton për apo kundër propozimeve të Këshillave të Fakulteteve.
3. Me vendimin e Senatit njoftohen të gjithë kandidatët që kanë plotësuar kushtet e konkursit.
4. Komisioni i ankesave dhe i parashtresave të Senatit përpilon një raport me shkrim, lidhur me ankesat e kandidatëve.
5. Në rast se komisioni i ankesave miraton apo refuzon pretendimet e kandidatëve, çështja mbyllet me vendim nga Senati.
6. Vendimi i Senatit është përfundimtar.

Neni 17

Pas miratimit të propozimeve të këshillave të fakulteteve nga Senati i UKZ-së, fakultetet përgatisin listat e personelit të angazhuar dhe i dorëzojnë në Zyrën për çështje akademike për përgatitjen e kontratave për nënshkrim, nga rektori i UKZ-së.

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET

Neni 18

Angazhimi, sipas kësaj rregulloreje nuk nënkupton themelim të marrëdhënies së rregullt të punës.

Kandidatëve të angazhuar. në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm, nuk iu takon e drejta në pushim vjetor dhe as kompensim të përvojës së punës.

Neni 19

Kandidatët e angazhuar bartin përgjegjësi ligjore për mënyrën e shfrytëzimit të aseteve të UKZ-së.

Neni 20

Kjo rregullore hynë në fuqi, nga dita e miratimit, nga Senati i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan.

Gjilan, 30. 06. 2021



Kryesuesi i Senati


Prof. Dr. Bajram Kosumi, rektor